

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësja e Jakup Krasniqit

Data: 18 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version i Redaktuar Publik i Kërkesës për Lirim të Përkohshëm, KSC-BC-2020-06/F00122, i datës 7 dhjetor 2020, me Shtojcat e redaktuara publike 1-2 dhe Shtojcën publike 3

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtësja e Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Mbrojtja e Jakup Krasniqit ("Mbrojtja") parashtrohet këtë kërkesë për lirim të përkohshëm në përputhje me nenin 41(6) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").
2. Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") nuk ka vërtetuar përmbushjen e kriterëve për paraburgim, të përcaktuara në nenin 41(6)(b): nuk ka vërtetuar se ekziston rreziku që z. Krasniqi të arratiset; nuk ka vërtetuar se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat; nuk ka vërtetuar se ai do të pengojë procesin duke ndikuar te dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; dhe nuk ka provuar se ai do të kryejë ndonjë veprë tjetër penale të përcaktuar. Rrjedhimisht, z. Krasniqi duhet të lirohet në varësi të kushteve që Gjykatësi i Procedurës Paraprake i gjykon të nevojshme.
3. Ky parashtim dorëzohet si konfidencial duke qenë se u referohet parashtrimeve konfidenciale në këtë çështje dhe të dhënave personale të z. Krasniqi.

II. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PERMBLEDHJE E SHKURTËR E JETËSHKRIMIT

4. Z. Krasniqi lindi më 1 janar 1951 (tani është 69 vjeç).¹ Ai është shtetas krenar i Kosovës dhe për vite të tëra punoi për të mbështetur pavarësinë e saj. Në vitin 1972 filloi punën si mësues ndërkohë që po kryente studimet, dhe si mësues punoi deri në vitin 1981 (me përjashtim të një periudhe prej 11 muajsh kur kreu shërbimin ushtarak). Në vitin 1974 filloi veprimtarinë klandestine në kuadër të Lëvizjes Kombëtare të

¹ KSC-BC-2020-06, F00045/A03, Prokurori i Specializuar, *Shtojcë 3 e Parashtrimit të Versioneve të Korrigjuara dhe të Redaktuara Publike të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të*, 4 nëntor 2020, publike, para. 10.

Kosovës. Si rezultat i kësaj veprimtarie, ai u hetua nga policia dhe u paralajmërua që të largohej nga Kosova. Ai nuk pranoi të largohej nga Kosova. U arrestua më 5 prill 1981, ose rreth kësaj date, dhe u mbajt në burg në vende të ndryshme, ndër të tjera në Vojvodinë, për dhjetë vjet, deri në lirim e tij më 23 korrik 1991, ose rreth kësaj date. [REDAKTUAR].² Ai përsëri nuk pranoi të largohej nga Kosova dhe në vend të kësaj u angazhua në Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe më vonë u bë zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. [REDAKTUAR]. Për herë të tretë ai nuk pranoi të largohej nga Kosova. Në vitet e fundit u angazhua si politikan në Kosovë dhe në vitet 2010 – 2011 shërbeu si ushtrues i detyrës së Presidentit të Kosovës.

5. Z. Krasniqi doli në pension në vitin 2016, në moshën 65 vjeçare, dhe tani merr pensionin e vet. Ai dha dorëheqjen si deputet në fillim të vitit 2015 dhe aktualisht nuk mban asnjë post shtetëror. Z. Krasniqi nuk kandidoi në zgjedhjet e vitit 2017 dhe 2019. Ai është ende kryetar i Këshillit Kombëtar të partisë së tij politike NISMA. NISMA është një parti e vogël dhe në koalicion me një parti tjetër fitoi 6 vende (nga gjithsej 120) në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019.³

6. [REDAKTUAR], z. Krasniqi banon kryesisht [REDAKTUAR].⁴

7. Z. Krasniqi ka bashkëpunuar edhe më parë me drejtësinë ndërkombëtare në çështje gjyqësore që kanë të bëjnë me Kosovën. Më 27 prill 2004, ai u thirr për intervistë nga Prokurori i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ("TPNJ"),⁵ u paraqit për atë intervistë dhe dha një deklaratë. Më pas, ai mori një urdhërparaqitje dhe e zbatoi atë duke u paraqitur në Hagë për të dhënë dëshmi më 10 – 15 shkurt 2005, ose rreth këtyre datave, pavarësisht nga fakti se personalisht ishte kundër akuzave të

² Shtojca Konfidenciale 2.

³ *Shih* Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës, Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2019, *Rezultatet Përfundimtare*, f. 2.

⁴ *Shih* Shtojca Konfidenciale 2.

⁵ *Shih* TPNJ, *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66, Transkript, 10 shkurt 2005, f. 3292, rreshtat 9-15.

ngritura ndaj të akuzuarve në atë çështje.⁶ Më 29 maj 2007, ai u thirr sërish në Hagë nga Prokurori i TPNJ-së për të dhënë dëshmi në një çështje tjetër dhe përsëri përmbushi atë kërkesë.⁷

8. Për më tepër, në korrik 2019, ZPS-ja e thirri z. Krasniqi në Hagë për ta intervistuar si të dyshuar. Z. Krasniqi përmbushi këtë kërkesë. Ai udhëtoi në Hagë më 23 korrik 2019 për t'u intervistuar nga ZPS-ja më 24 korrik 2019. Pas intervistës, z. Krasniqi u kthye në Kosovë në vendbanimin e tij të zakonshëm. Nuk ka asnjë provë që ai bëri ndonjë përpjekje për t'u arratisur ose për të ndikuar te dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit pas intervistimit të tij si i dyshuar, pavarësisht se iu bënë të ditura akuzat me të cilat përballej.

9. Më 24 prill 2020, ZPS-ja dorëzoi *ex parte* për konfirmim aktakuzën kundër z. Krasniqi dhe të tjerëve. Më 24 korrik 2020, në përputhje me një urdhër të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ZPS-ja dorëzoi për konfirmim një aktakuzë të rishikuar.⁸

10. Më 26 tetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e rishikuar,⁹ lëshoi fletarrestim për z. Krasniqi dhe urdhëroi transferimin e tij në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHSK").¹⁰

11. Më 4 nëntor 2020, z. Krasniqi u arrestua në shtëpinë e tij në [REDAKTUAR] dhe më pas u transferua në qendrën e paraburgimit të DHSK-së. Lëshimi i fletarrestimit *ex parte* qartë i mohoi z. Krasniqi mundësinë për t'u dorëzuar vullnetarisht, gjë të cilën

⁶ TPNJ, *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66, Transkript, 10 shkurt 2005, f. 3291, rreshti 2.

⁷ TPNJ, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84, Transkript, 29 maj 2007, f. 4942.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00027/A07, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Fletarrestimit për Jakup Krasniqin*, 26 tetor 2020, f. 1.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00026, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020.

¹⁰ KSC-BC-2020-06, F00027/A07, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Fletarrestimit për Jakup Krasniqin*, 26 tetor 2020.

ai do ta kishte bërë, siç bëri kur iu përgjigj fletëthirrjes për t'u intervistuar në korrik 2019.

12. Më 9 nëntor 2020, u mbajt seanca e paraqitjes së parë dhe z. Krasniqi doli para Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Z. Krasniqi u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat e paraqitura në Aktakuzë dhe Mbrojtja njoftoi Gjykatën se do të parashtronte kërkesë për lirim të përkohshëm.¹¹

13. Në përputhje me nenin 21(3) të Ligjit, z. Krasniqi konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij.

14. Më 18 nëntor 2020, në konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes, u diskutua në lidhje me procedurën e shqyrtimit të lirit të përkohshëm. Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri të ditur se Mbrojtja duhej të parashtronte një kërkesë me shkrim për lirim të përkohshëm.¹²

15. Gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes gjithashtu u tha se kjo çështje gjyqësore mund të zgjasë katër deri në pesë vjet, llogaritur nga koha e tanishme e deri në përfundimin e saj.¹³ Në vend se të shpjegonte qëndrimin e vet në konferencën mbi ecurinë e çështjes, ZPS-ja më pas paraqiti parashtrime shtesë me shkrim, duke pohuar se gjykimi duhet të fillojë këtë verë, ose jo më vonë se shtatori 2021.¹⁴ Mbrojtja këmbëngul se është shumë herët për të dhënë një vlerësim të arsyeshëm lidhur me kohëzgjatjen e hetimeve të Mbrojtjes¹⁵ dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake me të drejtë nuk tentoi të caktonte një datë për fillimin e gjykimit gjatë konferencës së parë

¹¹ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 9 nëntor 2020, f. 21, rreshtat 20-21.

¹² KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 18 nëntor 2020, f. 166, rreshtat 6-13.

¹³ Po aty, f. 165, rreshtat 9-10.

¹⁴ KSC-BC-2020-06, F00097, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë pas Konferencës së 18 nëntorit 2020 mbi Ecurinë e Çështjes*, 23 nëntor 2020, publike, para. 14.

¹⁵ KSC-BC-2020-06, F00082, Mbrojtja e z. Krasniqi, *Parashtrime të Mbrojtjes në Emër të Jakup Krasniqit për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes*, 17 nëntor 2020, publike, para. 4-7.

mbi ecurinë e çështjes.¹⁶ Sidoqoftë, ZPS-ja nënvlerëson plotësisht kohën që do t'i duhej Mbrojtjes për të kryer një hetim të arsyeshëm në këtë çështje. Megjithëse rezervon të drejtën e vet për të paraqitur parashtrime të hollësishme lidhur me datën e fillimit të gjykimit në kohën e duhur dhe në përputhje me udhëzimet e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, Mbrojtja në vijim parashtron dy pika të shkurtra që ilustrojnë papërshtatshmërinë e qëndrimit të ZPS-së. Së pari, më 11 dhjetor 2020,¹⁷ Mbrojtja do të marrë një version të redaktuar të dëshmive të 153 dëshmitarëve të parë nga 203 dëshmitarë që ZPS-ja synon të thërrasë.¹⁸ Nga ajo datë e deri në fillim të shtatorit 2021 mbeten vetëm 262 ditë. Edhe nëse supozojmë se redaktimet nuk do të krijojnë ndonjë pengesë për hetimin (gjë që është jorealiste – ZPS-ja së fundmi ka paraqitur [REDAKTUAR]¹⁹), ZPS-ja propozon që Mbrojtjes t'i lihet më pak se një ditë e gjysmë (madje edhe duke u nisur nga supozimi se Mbrojtja nuk do të marrë asnjë ditë pushim) për të hetuar dëshminë e secilit dëshmitar. Së dyti, sipas datës së fundit në kalendarin aktual të afateve për nxjerrjen e materialeve, ZPS-ja duhet të nxjerrë të paredaktuar materialin sipas rregullës 102(3), ose të paraqesë kërkesë për redaktimin e materialit sipas rregullës 102(3), më së voni deri më 5 korrik 2021.²⁰ Kjo është më pak se dy muaj përpara datës së propozuar nga ZPS-ja për fillimin e gjykimit (dhe nëse bëhet kërkesë për redaktime, Mbrojtja natyrisht që nuk do ta marrë materialin menjëherë). Janë pothuajse 100.000 materiale sipas rregullës 102(3).²¹ Është jorealiste të pritët që Mbrojtja të lexojë dhe përpunojë gjithë atë material dhe të jetë gati për fillimin e gjykimit brenda më pak se dy muaj.

16. Data e fillimit të gjykimit nuk duhet të përcaktohet në këtë moment. Sidoqoftë, gjatë marrjes së vendimit lidhur me kërkesat për lirim të përkohshëm, Gjykata nuk

¹⁶ KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 18 nëntor 2020, f. 116, rreshtat 15-17.

¹⁷ KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me to*, (“Vendimi Kornizë”), 23 nëntor 2020, publik, para. 99(b).

¹⁸ KSC-BC-2020-06, F00076, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë për Konferencën e Parë mbi Ecurinë e Çështjes*, 13 nëntor 2020, publike, para. 5.

¹⁹ [REDAKTUAR].

²⁰ Vendimi Kornizë, para. 99(h).

²¹ Po aty, para. 64.

duhet të marrë si të mirëqenë asnjë parashtrim të ZPS-së se kohëzgjatja e paraburgimit në pritje të gjykimit me gjasë do të jetë e shkurtër. Po qe se Mbrojtjes do t'i lejohet kryerja e hetimeve të arsyeshme²² pas përfundimit të afateve aktuale për nxjerrjen e materialeve dhe nëse mbahet parasysh koha e pritshme që do t'i duhet Prokurorisë për të thirrur rreth 200 dëshmitarë, si edhe katër ekipeve të Mbrojtjes për të paraqitur provat e veta, nuk është jorealiste të thuhet se, nëse nuk miratohet lirimi i përkohshëm, z. Krasniqi do të jetë në paraburgim për më shumë se katër vjet para se të shqiptohet ndonjë vendim.

17. Z. Krasniqi vazhdon të jetë në paraburgim të DHSK-së dhe mbajtja e tij e mëtejshme në paraburgim është e papërligjur.

18. Lirimi i përkohshëm i z. Krasniqi kërkohet kryesisht për t'i lejuar atij që të qëndrojë me familjen e vet në [REDAKTUAR], për këto katër deri pesë vjet, që realisht është kohëzgjatja e mundshme e gjykimit në këtë çështje. Z. Krasniqi nuk përbën dhe nuk ka përbërë asnjëherë rrezik arratisjeje. Gjatë gjithë kohës përkatëse ai ka jetuar në [REDAKTUAR], dhe ka qenë publikisht i disponueshëm, si dhe ka vazhduar të banojë në të njëjtën adresë ku banonte edhe para se të thirrej dhe të merrej në pyetje si i dyshuar nga ZPS-ja më 24 korrik 2019. Z. Krasniqi synon të vërtetojë pafajësinë e tij. Ai është 69 vjeç, i dalë në pension, dhe nuk ka ndërmend të rrezikojë jetën e vet familjare duke i ikur drejtësisë. Ai nuk u arratis edhe kur kishte mundësi të shumta për ta bërë këtë ndërmjet korrikut 2019 dhe nëntorit 2020, dhe, për këtë arsye, është e qartë që ai nuk përbën rrezik arratisjeje.

19. Për më tepër, z. Krasniqi zotohet të përmbushë çdo parakusht që mund të vendosë DHSK-ja (zotimi i tij me shkrim i bashkëngjitet kësaj kërkesë si shtojca konfidenciale 1). Ai konfirmon se në rast se i miratohet lirim i përkohshëm, ai:

²² Ekipeve të tjera të Mbrojtjes vlerësuan 18 muaj, *shih* KSC-BC-2020-06, Transkript i seancës, 18 nëntor 2020, f. 108, rreshti 16 deri në f. 109, rreshti 4.

- a. do të kthehet në DHSK për t'u përballur me akuzat ndaj tij në gjyq ose kurdoherë që do të thirret nga DHSK-ja për t'u paraqitur;
- b. do të tregojë adresën në të cilën do të qëndrojë në [REDAKTUAR] dhe do t'u përmbahet të gjitha kushteve që DHSK-ja mund të vendosë, përfshirë mosndryshimin e vendbanimit të tij;
- c. do të paraqitet rregullisht tek autoritetet siç mund të kërkohet nga DHSK-ja;
- d. nuk do të kontaktojë dhe/ose ndërhyjë te asnjë dëshmitarë ose person që ka lidhje me çështjen;
- e. nuk do të udhëtojë në komunat dhe vendndodhjet e tjera ku pretendohet se janë kryer krimet e përmendura në Aktakuzë (në mënyrë që të eliminohet më tej çdo rrezik i frikësimit ose ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve);
- f. nuk do të bëjë deklaratë publike për aspekte që kanë lidhje me çështjen, në media, me anë të rrjeteve sociale ose në ndonjë mënyrë tjetër; dhe
- g. do t'u përmbahet të gjitha kushteve të tjera që DHSK-ja mund të vendosë për miratimin e lirit të përkohshëm.

20. Duke pasur parasysh statusin e DHSK-së brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës,²³ nuk duhet të jetë e nevojshme të kërkohen garanci nga qeveria e Kosovës për gatishmërinë e saj për të siguruar riparaqitjen e z. Krasniqi para DHSK-së dhe për çështje të tjera. Në përputhje me nenin 53(1)(j) dhe (k) të Ligjit, të gjitha subjektet dhe personat në Kosovë janë të detyruar të bashkëpunojnë me DHSK-në dhe ZPS-në, duke përfshirë në lidhje me arrestimin, paraburgimin dhe transferimin e personave në DHSK. Sipas nenit 54(7), DHSK-ja dhe ZPS-ja mund të kërkojnë edhe ndihmën e ndonjë gjykate në Kosovë. Rrjedhimisht, Qeveria e Kosovës është e detyruar të

²³ Neni 1(2) i Ligjit.

arrestojë z. Krasniqi dhe të sigurojë transferimin e tij në DHSK, nëse i kërkohet, dhe nuk ka nevojë për garanci të mëtejshme.²⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

21. Në nenin 41(6) të Ligjit thuhet:

Dhomat e Specializuara apo Prokurori i Specializuar urdhërojnë arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur:

- a. ekziston dyshimi i bazuar se ai e ka kryer ndonjë veprë penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara, dhe
- b. ekzistojnë arsye të artikuleshme të besohet se:
 - i. ekziston rreziku i arratisjes;
 - ii. se ai ose ajo do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e ndonjë veprë penale, ose rrethanat specifike tregojnë se ai do të pengojë ecurinë e procedurës penale duke ndikuar tek dëshmitarët, palët e lënduara ose bashkëfajtorët, ose
 - iii. natyra e rëndë e veprës penale, ose mënyra apo rrethanat në të cilat është kryer dhe karakteristikat personale të tij, sjellja e tij në të shkuarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat ai jeton, ose rrethanat e tjera personale e tregojnë rrezikun se ai do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë ndonjë veprë penale në tentativë, ose do të kryejë ndonjë veprë penale që ai ka kërcënuar se do ta kryejë.

22. Rregulla 57(2) përcakton se:

Pas caktimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit, dhe deri kur aktgjykimi të marrë formë të prerë, paneli i angazhuar me çështjen vlerëson vendimin mbi mbajtjen në paraburgim, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, në përputhje me nenin 41(6), (10), (11) dhe (12) të Ligjit, ose në çdo kohë me kërkesë të të akuzuarit ose Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.

23. Gjithashtu, neni 3(2) i Ligjit përcakton se Dhomat e Specializuara duhet të “gjykojnë dhe funksionojnë” në përputhje me “(a) Kushtetutën e Republikës së Kosovës” dhe

²⁴ Në rast se ZPS-ja nuk pajtohet me këtë qëndrim, Mbrojtja rezervon të drejtën të paraqesë garancitë e duhura në Kundërpërgjigjen.

“(e) të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që përcakton standardet e drejtësisë penale përfshirë Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilave iu është dhënë përparësi kundrejt ligjeve vendore me nenin 22 të Kushtetutës”.

24. Neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat e njeriut *“zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”.*

25. Ndër të drejtat themelore që kanë përparësi ndaj çdo dispozite tjetër të Ligjit janë edhe e drejta e lirisë, e përcaktuar në nenin 5(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”), e drejta për t'u liruar në gjykim e sipër (neni 5(3) i KEDNJ-së) dhe e drejta e lirisë së shprehjes (neni 10 i KEDNJ-së).

26. Parimet që zbatohen për paraburgimin në pritje të gjykimit, si një çështje e së drejtës për të drejtat e njeriut, janë të përcaktuara qartë. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vlerësuar se paraburgimi është një shmangie e jashtëzakonshme nga e drejta e lirisë dhe e lejueshme vetëm në raste rreptësisht të përcaktuara.²⁵ Është autoriteti i ndjekjes penale ai që mbart detyrimin e vërtetimit të fakteve konkrete që peshojnë më shumë se parimi i respektimit të lirisë individuale;²⁶ barra e vërtetimit nuk duhet t'i bartet personit të paraburgosur për ta detyruar atë të arsyetojë lirimin e vet.²⁷ Gjithashtu, vazhdimi i paraburgimit mund të përlligjet në një rast të caktuar vetëm kur ka tregues konkretë të një kushti të njëmendtë me interes publik, që, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, peshon më shumë se parimi i respektimit të lirisë së individuale.²⁸ Këto prova duhet të lidhen me faktet specifike të çështjes dhe

²⁵ GJEDNJ/ECtHR, *Ilijkov v. Bulgaria*, no. 33977/96, *Judgment*, 26 July 2001, para. 85.

²⁶ Po aty, para. 84-85.

²⁷ GJEDNJ, *Bykov v. Russia*, no. 4378/02, *Judgment*, 10 March 2009, para. 64.

²⁸ Po aty., para. 62.

me rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës;²⁹ ato nuk duhet të jenë të përgjithshme ose abstrakte.³⁰

27. Megjithëse zbaton një standard të ndryshëm në përputhje me Rregulloren e saj të Procedurës dhe të Provave, jurisprudenca e TPNJ-së ofron udhëzime për faktorët përkatës që duhen marrë parasysh në lidhje me lirimin e përkohshëm. TPNJ-ja thekson gjithashtu se vendimet për lirim të përkohshëm varen nga faktet dhe duhet të shqyrtohen individualisht, duke mbajtur parasysh rrethanat konkrete të individit të akuzuar.³¹ Në një çështje me më shumë të akuzuar, kjo do të thotë që pozita e secilit prej tyre duhet të vlerësohet individualisht.³² Si rrjedhojë, në një çështje që lidhet me Kosovën, TPNJ-ja vlerësoi se provat e përgjithshme të ndërhyrjes të dëshmitarët nuk janë të mjaftueshme, sepse për të refuzuar lirimin e përkohshëm duhet të tregohet se i akuzuari paraqet një rrezik konkret të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve.³³ Gjithashtu, është pranuar gjerësisht se bashkëpunimi i mundshëm i shtetit në të cilin parashtruesi i kërkesës kërkon të lirohet dhe garancitë e ofruara nga vetë parashtruesi i kërkesës janë faktorë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh.³⁴

28. Z. Krasniqi nuk pranon që ekziston dyshim i bazuar se ai kreu krimet e pretenduara. Ai pret nxjerrjen nga ZPS-ja të materialeve që mbështesin Aktakuzën. Në këto rrethana, kjo kërkesë për lirim të përkohshëm bazohet në pjesën e dytë të standardit të nenit 41(6) – domosdoshmëria e paraburgimit.

²⁹ GJEDNJ, *Aleksanyan v. Russia*, no. 46468/06, *Judgment*, 22 December 2008, para. 179.

³⁰ GJEDNJ, *Boicenco v. Moldova*, no. 41088/05, *Judgment*, 11 July 2006, para. 142; GJEDNJ, *Khudoyorov v. Russia*, no. 6847/02, *Judgment*, 8 November 2005, para. 173.

³¹ TPNJ/ICTY, *Prosecutor v. Hadzić*, IT-04-75-T, *Decision on Defence Urgent Request for Provisional Release*, 13 March 2015, para. 30; ICTY, *Prosecutor v. Prlić et al.*, IT-04-74-AR65.35, *Decision on the Prosecution's Appeal of the Decision on Further Extension of Milivoj Petković's Provisional Release*, 12 June 2012, para. 6.

³² TPNJ, *Prokurori kundër Shainoviqit dhe të tjerëve*, IT-99-37-AR65, *Vendim për lirim të përkohshëm*, 30 tetor 2002, para. 7.

³³ TPNJ, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84-PT, *Vendim mbi kërkesën e Ramush Haradinajt për lirim të përkohshëm*, 6 qershor 2005, para. 46-48.

³⁴ TPNJ, *Prokurori kundër Shainoviqit dhe të tjerëve*, IT-99-37-AR65, *Vendim për lirim të përkohshëm*, 30 tetor 2002, para. 6.

29. Në përputhje me shembujt e mësipërm të GJEDNJ-së, neni 41(6)(b) i Ligjit presupozon qartë se liria është pozicion i paracaktuar dhe se paraburgimi për ligjet vetëm nëse ekzistojnë “arsye të artikulueshme për të besuar” se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b). As Ligji dhe as Rregullorja nuk japin ndonjë sqarim lidhur me këtë standard provues.

30. Interpretimi i këtyre dispozitave brenda kuptimit të kritereve të përgjithshme të së drejtës për të drejtat e njeriut e bën të qartë se, për të arsyetuar paraburgimin, ZPS-ja duhet të paraqesë prova konkrete dhe specifike se vetë z. Krasniqi përbën rrezik arratisjeje, se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat, do të pengojë ecurinë e procesit përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit, ose do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një veprë penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë. Gjithashtu, përdorimi i fjalës “ekziston” në nenin 41(6)(b)(i) lidhur me rrezikun e arratisjes dhe i fjalës “do të” në nenin 41(6)(b)(ii) dhe (iii) sugjeron një standard të lartë prove që kërkon vërtetimin e më shumë se thjeshtë mundësisë. Provat nuk i mbështesin këto përfundime dhe, rrjedhimisht, z. Krasniqi duhet t’i miratohet lirim i përkohshëm.

IV. ZPS-JA NUK KA VËRTETUAR PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE TË PËRCAKTUARA NË NENIN 41(6)(1)(b)

31. Mbrojtja parashtron se ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete ose specifike se z. Krasniqi – gjykuar si individ – përbën rrezik arratisjeje, se ai do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat, do të pengojë ecurinë e procesit përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit, ose do të kryejë krime të tjera, siç përcaktohet në nenin 41(6)(b).

1. Z. Krasniqi nuk përbën rrezik arratisjeje

32. Bazuar në faktet e kësaj çështjeje, mbështetja e ZPS-së në peshën e akuzave dhe dënimin e mundshëm nëse shpallet fajtor, në postet e mëparshme politike të z. Krasniqi dhe në mundësinë e tij për të udhëtuar, nuk vërteton se ai përbën rrezik arratisjeje. Përkundrazi, duke marrë parasysh të gjithë faktorët e rëndësishëm dhe rrethanat konkrete dhe personale të z. Krasniqi, është e qartë se ai nuk përbën rrezik arratisjeje.

33. Për sa u përket rrethanave konkrete të z. Krasniqi, ekzistojnë arsye bindëse për të besuar se ai nuk përbën rrezik arratisjeje. Ai është pothuajse 70 vjeç. [REDAKTUAR]. Ai ka rrënjë të thella në Kosovë. [REDAKTUAR].³⁵ Nuk ka gjasa që ky pensionist të ikë nga shtëpia apo familja e vet në Kosovë.

34. Për më tepër, z. Krasniqi ka pasur mundësi të arratiset nga Kosova edhe më parë. Ai nuk u arratis nga Kosova kur ishte shumë më i ri, në vitin 1981, kur e dinte se ishte nën hetim dhe mund të burgosej. Ai nuk u arratis nga Kosova në vitin 1991 [REDAKTUAR] Ai nuk kërkoi azil gjatë konfliktit. Në vend të kësaj, ai ia kushtoi jetën pavarësisë së Kosovës dhe më parë ka qenë i burgosur për 10 vjet për shkak të mbështetjes së tij për Kosovën. Do të ishte krejtësisht jashtë karakterit të tij që të arratiset nga Kosova tani.

35. Përveç këtyre rrethanave personale, z. Krasniqi ka dhënë garanci me shkrim se do të kthehet për t'u përballur me akuzat.³⁶ Kjo garanci mbart peshë sepse figura e tij publike do të dëmtohej nëse ai do të shkelte fjalën e dhënë. Z. Krasniqi thekson se është i gatshëm t'u përmbahet të gjitha kushteve që mund të vendosë Gjykata, që mund të përfshijnë paraqitjen rregullisht para autoriteteve të Kosovës dhe dorëzimin e pasaportës. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës ka detyrimin e bashkëpunimit me DHSK-

³⁵ Shtojca Konfidenciale 2.

³⁶ Shtojca Konfidenciale 1.

në në arrestimin dhe transferimin e personave.³⁷ Ky detyrim bashkëpunimi, marrë së bashku me garancitë personale të z. Krasniqi dhe kompetencën e DHSK-së për të vendosur kushtet e nevojshme, eliminon çdo rrezik të mundshëm të arratisjes.

36. ZPS-ja pretendon se rreziku i arratisjes është i pranishëm sepse z. Krasniqi është në dijeni të akuzave kundër tij, të dënimeve të mundshme që mund të përfshijnë dënim deri në burgim të përjetshëm, si dhe të vendimeve të fajësisë penale kundër anëtarëve të tjerë të pretenduar të NKP-së.³⁸

37. ZPS-ja nuk përmend faktin se z. Krasniqi ka një histori të respektimit të fletëthirrjeve të gjykatave ndërkombëtare. Pikërisht në këtë çështje, ai mori një fletëthirrje për t'u paraqitur para ZPS-së më 24 korrik 2019 për t'u marrë në pyetje në cilësinë e të dyshuarit. Në fletëthirrjen e ZPS-së thuhej qartë se ai ishte nën hetim dhe gjatë marrjes në pyetje ai u njoftua se po hetohej për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Për këtë arsye, të paktën më 24 korrik 2019, z. Krasniqi ishte në dijeni të peshës së akuzave kundër tij dhe të dënimeve të mundshme. ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë që ai bëri ndonjë përpjekje për t'iu shmangur drejtësisë gjatë periudhës prej më shumë se një viti e tre muajsh ndërmjet marrjes në pyetje dhe arrestimit të tij. Përkundrazi, ai veprroi në përputhje të plotë me fletëthirrjen dhe udhëtoi vullnetarisht për në Hagë për t'u marrë në pyetje. Ai më pas u kthye në Kosovë dhe ishte në vendbanimin e tij të zakonshëm në Kosovë deri ditën kur u arrestua, më 4 nëntor 2020. Nëse dijenia për akuzat dhe dënimet e mundshme do të ishte një arsye që ai të arratisesh, z. Krasniqi kishte mundësi të shumta për t'u arratisur, si kur mori fletëthirrjen, ashtu edhe pas marrjes në pyetje. Ai nuk e bëri këtë.

³⁷Shih neni 53 i Ligjit.

³⁸ KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i 'Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to', parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 14 nëntor 2020, para. 31.*

38. Z. Krasniqi ka respektuar edhe fletëthirrje dhe urdhërparaqitje të tjera ndërkombëtare në të kaluarën. Siç u përmend më lart,³⁹ ai u thirr për intervistë nga Prokurori i TPNJ-së dhe mori urdhërparaqitje për të dhënë dëshmi gojore në gjyq. Secilën herë ai i respektoi ato, megjithëse personalisht ishte kundër përmbajtjes së akuzave. Nuk ka absolutisht asnjë arsye për të besuar se ai do të sillej ndryshe tani.

39. Z. Krasniqi është i vendosur të përballet me akuzat kundër tij. Ai e di se disa anëtarë të pretenduar të NKP-së janë shpallur fajtor për disa krime të pretenduara. Ai gjithashtu e di se anëtarë të tjerë të pretenduar të NKP-së janë shpallur të pafajshëm dhe se prokurorët ndërkombëtarë nuk kanë arritur të vërtetojnë akuza të ngjashme për një NKP gjithëpërfshirëse ose për përgjegjësi eprore në çështje të tjera gjyqësore.⁴⁰ Ai është i gatshëm të mbrohet në këtë çështje dhe të hedhë poshtë akuzat kundër tij. Mundësia e një dënimi me burgim të gjatë nëse shpallet fajtor, që është një faktor i përgjithshëm që mund të zbatohet në çdo çështje në të cilën ngrihen akuza të rënda, në rastin konkret nuk përcakton ndonjë rrezik për arratisje. Z. Krasniqi tashmë ka qenë i burgosur për 10 vjet në vitet 1981 – 1991 dhe atë nuk e frikëson mundësia e një dënimi me burgim të gjatë, po qe se do të shpallej fajtor.

40. ZPS-ja gjithashtu pretendon se ekziston rreziku i arratisjes sepse, si udhëheqës aktual apo i mëparshëm politik, i akuzuari ka mjetet dhe mundësinë për t'u arratisur. Ndërsa mund të thuhet se z. Krasniqi ka pasur një karrierë të shquar politike, ai ka dalë në pension para katër vitesh. Ai aktualisht nuk mban asnjë post shtetëror dhe partia e tij ka vetëm 6 nga gjithsej 120 deputetë në Kuvendin e Kosovës. ZPS-ja nuk paraqet asnjë provë që ai aktualisht ka ndonjë kontroll ose ndikim mbi Qeverinë e Kosovës, mbi ndonjë rrjet të gjerë përkrahësish, apo që më parë ka përdorur postet publike që ka mbajtur për t'iu shmangur drejtësisë.

³⁹ Shih më lart, para. 7.

⁴⁰ TPNJ, *Prokurori kundër Limajt dhe të tjerëve*, IT-03-66-T, *Aktgjykim*, 30 nëntor 2005; TPNJ, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve.*, IT-04-84-T, *Aktgjykim*, 3 prill 2008; TPNJ, *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, IT-04-84bis-T, *Aktgjykim i Rigjykimit*, 29 nëntor 2012.

41. Së fundi, ZPS-ja pretendon se i akuzuari ka qasje në fonde të konsiderueshme dhe mund të udhëtojë lirisht.⁴¹ Mbrojtjes nuk i është dhënë asnjë provë që vërteton se z. Krasniqi ka qasje në fonde të konsiderueshme. Sido që të jetë, megjithëse z. Krasniqi mund të udhëtojë (në kuptimin që shumica e njerëzve mund të udhëtojnë), një provë e tillë e përgjithshme dhe abstrakte nuk vërteton ekzistencën e një rreziku konkret për arratisje. Z. Krasniqi gjithmonë ka pasur mundësinë për të udhëtuar por nuk ka asnjë provë që ai të ketë tentuar ndonjëherë të arratiset ose t'i fshihet drejtësisë. Garancitë e që jep z. Krasniqi tregojnë se ai do të jetojë dhe qëndrojë në adresën e [REDAKTUAR] deri në përfundimin e kësaj çështjeje gjyqësore, dhe se nuk ka ndërmend të udhëtojë për diku tjetër.

42. ZPS-ja nuk ka vërtetuar se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se z. Krasniqi përbën rrezik arratisjeje.

2. Z. Krasniqi nuk do të pengojë procesin përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit

43. ZPS-ja pohon, me një gjuhë të përgjithshme dhe pa dhënë ndonjë hollësi, se 'të dyshuarit' mund të pengojnë procesin me anë të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve, viktimave ose bashkëkryesve.⁴² Megjithatë, ZPS-ja nuk saktëson konkretisht asnjë rrethanë që do ta bënte një vëzhgues objektiv dhe të pavarur të besonte se këto pretendime janë të bazuara. Thjesht nuk ka asnjë provë se z. Krasniqi, i marrë si individ, ka asgjësuar ose do të asgjësojë, fshehtë, ndryshojë apo falsifikojë prova, ose se është orvatur të pengojë procesin apo të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve, viktimave ose

⁴¹ KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i 'Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to'*, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 14 nëntor 2020, para. 32-33.

⁴² KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i 'Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to'*, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 14 nëntor 2020, para.34-38.

bashkëkryesve. Në fakt, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më parë konstatoi se nuk ekziston dyshim i bazuar se z. Krasniqi ka bërë përpjekje të ndërhyjë në administrimin e drejtësisë.⁴³ Rrjedhimisht, nuk ka asnjë tregues se ai do ta bëjë këtë, ose ka të ngjarë ta bëjë këtë në të ardhmen, nëse lirohet.

44. ZPS-ja mbështetet gjerësisht në “atmosferën e kërcënimit dhe frikësimit të dëshmitarëve” në Kosovë.⁴⁴ Megjithëse mund të jetë një faktor i rëndësishëm, ZPS-ja pranon se ky nuk mund të jetë faktori i vetëm që përlligj paraburgimin dhe se si bazë kryesore duhet të merren rrethanat që kanë të bëjnë me vetë individin.⁴⁵ Në fakt, asnjë atmosferë e përgjithshme nuk mund të vërtetojë se vetë z. Krasniqi do të pengojë procedimin përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat apo bashkëkryesit.⁴⁶

45. Nga pretendimet e ndryshme të ZPS-së të paraqitura në paragrafët 3-26 të Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve, vetëm dy në të vërtetë kanë të bëjnë personalisht me z. Krasniqi: se ai ishte pjesë e “diatribës shumëvjeçare kundër DHSK-së”;⁴⁷ dhe se më 24 prill 2020, në një postim në Fejsbuk, e quajti Shkëlzen Gashin kolaboracionist pse kishte deklaruar se individë të caktuar nga radhët e UÇK-së kishin kryer krime.⁴⁸ Asnjë nga këto pretendime nuk vërteton se ai do të pengojë procesin gjyqësor përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat apo bashkëkryesit.

⁴³ KSC-BC-2020-06, F00031, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Korrigjuar i Vendimit për Autorizimin e Kontrollimit dhe Sekuestrimit*, 26 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 25.

⁴⁴ KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i ‘Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to’*, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 14 nëntor 2020, para. 34.

⁴⁵ Po aty, poshtëshënimi 102.

⁴⁶ Shih TPNJ, Prokurori k. Haradinajt dhe të tjerëve, IT-04-84-PT, *Vendim mbi Kërkesën e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm*, 6 qershor 2005, para. 46-48.

⁴⁷ KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i ‘Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to’*, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 14 nëntor 2020, para. 7.

⁴⁸ KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i ‘Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to’*, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, para. 5.

46. Z. Krasniqi pranon që ka shprehur mendimin e vet se DHSK-ja nuk duhej të ishte krijuar. Është e vërtetë që e ka përshkruar Raportin Marti si një raport racist dhe se e ka kundërshtuar krijimin e DHSK-së për arsye politike. Këto janë mendimet e tij politike dhe ai ka të drejtën t'i shprehë ato lirshëm⁴⁹, në përputhje me lirinë e shprehjes, të garantuar në nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kritikën e tij në adresë të DHSK-së dhe themelimit të saj nuk përbëjnë dhe nuk mund të barazohen me pengimin e ecurisë së procedurave të Gjykatës, dhe aq më pak me ndërhyrjen ndaj dëshmitarëve, viktimave ose bashkëkryesve. Provat që citon ZPS-ja nuk janë tjetër veçse shprehje legjitime e mendimeve politike të tij; ato nuk vërtetojnë që ai është përpjekur të ndërhyjë në proceset e Gjykatës apo të ndërhyjë ndaj ndonjë dëshmitari. Në fakt, tani që është themeluar DHSK-ja, me gjithë pikëpamjen e tij se DHSK-ja nuk duhej të ishte krijuar, z. Krasniqi ka mbështetur procesin e drejtësisë. Edhe në materialin që citon ZPS-ja, më 20 dhjetor 2018, në një koment në lidhje me çështjen *Mustafa*, edhe pse ishte kritik ndaj themelimit të Gjykatës, z. Krasniqi prapëseprapë deklaroi: "Mendoj se drejtësisë në cilëndo cilësi nuk duhet t'i ikë askush".⁵⁰ Po ashtu, më 15 tetor 2017, *Gazeta Express* botoi një intervistë me z. Krasniqi në të cilën ai u pyet nëse Kosova duhet të bashkëpunojë me DHSK-në dhe u përgjigj: "Tani Gjykata Speciale është e Kosovës ani pse gjendet jashtë saj. Drejtësisë nuk duhet t'i ikë askush, as brenda e as jashtë Kosovës. Ndonëse qëndrimi im për atë Gjykatë ka qenë krejt publik dhe asgjë nuk ka ndodhur ndërkohë që të ndryshoj mendim".⁵¹ Sa i përket z. Krasniqi, logjikisht nuk mund të nxirret përfundim dhe nuk ka asnjë provë që kritikën e tij të mëhershme ndaj krijimit të DHSK-së nënkuptojnë pengim të proceseve të DHSK-së dhe ndërhyrje ndaj dëshmitarëve, viktimave apo bashkëkryesve. Përkundrazi, ai e ka bërë të qartë se megjithëse nuk pajtohet me krijimin e DHSK-së, askush nuk duhet t'i ikë drejtësisë.

⁴⁹ Neni 10 i KEDNJ-së.

⁵⁰ KSC-BC-2020-06, F00005/0A2, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Versionit të Redaktuar Konfidencial të 'Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to', parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 14 nëntor 2020, f. 15.*

⁵¹ Shtojca Publike 3; shih gjithashtu *Gazeta Express*, Intervistë me z. Krasniqi, 15 tetor 2015.

47. Për sa i përket postimit në Fejsbuk të 24 prillit 2020, ai në thelb përbën përsëritje të mendimit që z. Krasniqi ka shprehur për vite me radhë në lidhje me Raportin Marti dhe krijimin e DHSK-së. Ai nuk identifikon asnjë individ me emër dhe nuk i bën thirrje askujt për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve, bashkëkryesve apo viktimave. Nuk ka asnjë provë që e lidh atë postim drejtpërdrejt me z. Gashi, si dhe asnjë provë se z. Gashi ka qenë viktimë ose dëshmitar, apo i lidhur në ndonjë mënyrë tjetër me procedurat e DHSK-së. Sido që të jetë, ky postim i vetëm është bërë më shumë se gjashtë muaj përpara arrestimit të z. Krasniqi. Po të kishte besuar me të vërtetë se postimi përbënte një kërcënim për dëshmitarët ose viktimat, ZPS-ja do të kishte ndërmarrë veprim shumë më herët se nëntori i vitit 2020. Sido që të merret, postimi në Fejsbuk nuk vërteton se z. Krasniqi do të pengojë procedurat e Gjykatës përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat apo bashkëkryesit, dhe/ose do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një vepre penale.

48. Sidoqoftë, z. Krasniqi është i gatshëm të pajtohet me kushtin që nuk do të bëjë deklaratë publike, nuk do të flasë me mediat dhe nuk do të bëjë postime në rrjetet sociale në lidhje me këtë çështje. Ai është gjithashtu i gatshëm të pranojë kushtin që të mos largohet nga vendbanimi i tij dhe të mos udhëtojë në komuna të tjera të përmendura në aktakuzë. Ai do të përmbushë çdo kusht tjetër që do të vendosë Gjykata. Vendosja e këtyre kushteve do të hiqte çdo shqetësim në lidhje me ndërhyrjen në proceset e Gjykatës.

49. Të gjitha pretendimet e tjera të ZPS-së janë të përgjithshme dhe abstrakte dhe kanë të bëjnë me të akuzuarit e tjerë ose me situatën e përgjithshme në Kosovë. Z. Krasniqi duhet të trajtohet si individ dhe jo si pjesë e një grupi monolit të dyshuarish. Për të arsyetuar paraburgimin e tij sipas nenit 41(6)(b), ZPS-ja duhet të paraqesë prova konkrete dhe specifike që ai, si individ, do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një vepre penale dhe/ose do të pengojë Gjykatën duke ndikuar mbi

dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit. Nuk është paraqitur asnjë provë e tillë. Nuk është paraqitur asnjë provë që ai personalisht “ka dhe ushtron ndikim të madh”, ka “aftësinë të manipulojë organet e qeverisë” ose të “mobilizojë baza të reja të mbështetjes”.⁵² E thënë ndryshe, nuk ka asnjë provë që lirimi i tij me kushte do të kishte ndonjë ndikim të konsiderueshëm në gjendjen e dëshmitarëve ose hetimet në Kosovë. Për rrjedhojë, standardi i përcaktuar në nenin 41(6)(b)(ii) nuk është plotësuar.

3. Z. Krasniqi nuk do të përsërisë veprën penale, nuk do të përfundojë një vepër penale të tentuar ose kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë

50. ZPS-ja gjithashtu pretendon se z. Krasniqi mund të kryejë vepra të tjera penale bazuar në atë që ai është “qartësisht i aftë të orkestrojë veprime të dhunës”.⁵³ Ky pretendim duket se bazohet tërësisht në pretendimet që qëndrojnë në themel të vetë Aktakuzës. Z. Krasniqi i mohon akuzat. Ai ka përparësinë e të prezumuarit i pafajshëm. Sido që të jetë, të gjitha pretendimet janë në lidhje me ngjarje që kanë ndodhur në periudhën 1998 – 1999, më shumë se njëzet vjet më parë. Nuk ka asnjë provë të ndonjë veprimtarie kriminale në periudhën e ndërmjetme. Z. Krasniqi tani është gati 70 vjeç. Ai nuk mban asnjë post shtetëror dhe as pozitë komanduese mbi dikë. Ai është një pensionist, posti i vetëm i të cilit është ai i Kryetarit të Këshillit Kombëtar të një partie të vogël politike, dhe nuk ka të bëjë aspak me përdorimin e një rrjeti përkrahësish. Thjesht nuk ka asnjë provë që ai me gjasë do të kryejë vepra të tjera penale.

51. Sidoqoftë, formulimi i nenit 41(6)(b)(iii) është i ngushtë dhe specifik. Nuk mjaftohet vetëm me rrezikun e përgjithshëm të përsëritjes së veprës penale, por

⁵² KSC-BC-2020-06, F00005, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Konfidencial i ‘Kërkesës për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave në lidhje me to’*, parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-06/F00005 datë 28 maj 2020, 14 nëntor 2020, para. 4.

⁵³ Po aty, para. 39-40.

kërkon që ZPS-ja të vërtetojë rrezikun se z. Krasniqi do të “përsërisë veprën penale” ose “përfundojë ndonjë vepër penale në tentativë” ose “kryejë ndonjë vepër penale që ai ka kërcënuar se do ta kryejë”. Nëse i marrim këto në rend të kundërt, ZPS-ja nuk paraqet asnjë provë se z. Krasniqi ka kërcënuar të kryejë vepra të tjera penale. ZPS-ja nuk paraqet asnjë provë që identifikon ndonjë vepër penale në tentativë që z. Krasniqi mund të përpiqet ta përfundojë. ZPS-ja nuk paraqet asnjë provë se z. Krasniqi do të “përsërisë veprën penale” duke qenë se është i akuzuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit që pretendohet se janë kryer para më shumë se 20 vitesh, gjatë një konflikti që ka kohë që ka përfunduar. Rrjedhimisht, standardi i përcaktuar në nenin 46(1)(b)(iii) thjesht nuk është plotësuar.

V. KËRKESË PER SHKURTIMIN E AFATIT DHE PËR SEANCË DËGJIMORE

52. Mbrojtja kërkon afat të përshpejtuar në mënyrë që kjo kërkesë të mund të shqyrtohet përpara pushimit të Gjykatës. Në përputhje me rregullën 9(5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka kompetencën të shkurtojë kohën e cilitdo afati. Në lidhje me lirimin e përkohshëm, ZPS-ja ka paraqitur parashtrimet e saj në lidhje me nenin 41(6)(b) në Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Urdhrave lidhur me to. Kjo kërkesë nuk do të jetë ndonjë befasi për ZPS-në, pasi që u paralajmërua si në seancën e paraqitjen së parë të z. Krasniqi, po ashtu edhe në konferencën e fundit mbi ecurinë e çështjes. Rrjedhimisht, Mbrojtja parashtron se ka arsye të vlefshme për të urdhëruar ZPS-në që të parashtrrojë përgjigjen e vet ndaj këtyre mocioneve brenda 5 ditësh dhe Mbrojtja të kundërpërgjigjet brenda 2 ditësh nga marrja e përgjigjes së ZPS-së.

53. Më tej, siç është bërë e qartë gjatë konferencës mbi ecurinë e çështjes, Mbrojtja kërkon zyrtarisht që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të caktojë një seance gojore, në përputhje me rregullën 95(2)(d) të Rregullores. Mbajtja e një seance gojore është e përligjur duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtave dhe çështjes në fjalë për z.

Krasniqi. Veç kësaj, ky do të jetë një nga vendimet e para të DHSK-së në lidhje me lirimimin e përkohshëm dhe risia e kësaj çështjeje për ligj më tej mbajtjen e një seance gojore. Nëse afati shkurtohet siç parashtrahet më lart, sipas mendimit të Mbrojtjes seanca do të mund të mbahej më 17 ose 18 dhjetor 2020.

VI. MASA QË KËRKOHET

54. Mbrojtja kërkon me respekt që Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. të shkurtojë afatin për dorëzimin e parashtrimeve me shkrim;
- b. të mbajë një seancë gojore më 17 ose 18 dhjetor 2020, ose sa më shpejt që të jetë e mundur pas dorëzimit të Kundërpërgjigjes;
- c. të konstatojë se kushtet për paraburgim sipas nenit 41(6) nuk janë përmbushur dhe të lirojë z. Krasniqi nga paraburgimi, sipas atyre kushteve që Gjykatësi i Procedurës Paraprake i gjykon të nevojshme dhe të përshtatshme.

Numri i fjalëve (në origjinal): 6.298

**Mbrojtësja e Specializuar
Venkatesvari Alagendra**

_____/nënshkrimi/_____

E hënë, 18 dhjetor 2020
Në Kuala Lumpur, Malajzi.